



Giuseppe Bova

GIUSEPPE BOVA

VËRSHIMET

-Poezi-

Biblioteka



Edition IWA BOGDANI

www.iwabogdani.org

iwabogdani@gmail.com

IWA Bogdani, Brussels – Prishtinë

0032494464251

Drejtor i botimeve **Jeton Kelmendi**

Autor: **Giuseppe Bova**

Redaktor: **Engjëll I. Berisha**

Përktheu nga Italishtja: **Anila Dahriu**

Dizajni i brendshëm: **Bogdani Design**

Ballina: **IWA Bogdani**

Copyright © **IWA Bogdani**

ISBN 978-9951-394-37-6

GIUSEPPE BOVA

VËRSHIMET



**Bruxelles – Pristina
2025.**



VËRSHIMET

*Atyre që nuk bëjnë zhurmë
ndërsa ëndrra shkon,
për ata që dinë t'i bëjnë vetes një dhuratë.*



PARATHËNIE

Nga Dante Maffia

“Çdo vend i përket pafundësisë”. Nëse dëshirojmë të hyjmë në sekretet e poezisë së Pino Bovës, duhet të niseni nga kjo deklaratë urdhëruese. Në vështrimin dhe në zemrën e tij është vendosmëria që trokitjet e jetës janë të shpërndara kudo dhe nuk ka nevojë për një shkop magjik për ta rizgjuar atë, për ta bërë atë të kthehet për të qenë pjesë e kuptimit, dinamika e prekshme e udhëtimit tokësor.

Këqyret mirë që Pino Bova e përjeton intensivisht dimensionin metafizik me gjërat dhe me qeniet njerëzore, me ëndrrat dhe me gjithçka që e rrethon dhe rrjedhimisht prej tij nxjerr sigurinë dhe dyshimet që e bëjnë të ndihet në plotësinë e ekzistencës, në syrin e ngrohtë të ciklonit që degëzohet si shumë degë për t'u bërë një lumë i tërbuar, një lumë që nuk ka dhe nuk do të ketë kurrë një shtrat të vetëm gjithashtu që nuk rrjedh dhe nuk do të rrjedhë kurrë vetëm në një zonë, por në të gjithë botën.

Kjo antologji e vogël e veprave të Bovës është para së gjithash një akt besimi në jetë dhe dashuri, një ftesë për të mos hequr dorë nga projektet personale për sa kohë që ato nuk bien ndesh me universalen.

Duhet patur kujdes, sepse, poeti niset gjithmonë nga të dhënat reale, nuk thellohet në gjarpërimet e teorizimeve dhe rrjedhimisht që vargjet e tij kanë atë shijen e ëmbël dhe të hidhur që troket në derën e pafundësisë për të kërkuar një fjalë tjetër magjike të fjalorit të tij, të mund të hysh në zjarrin magjik, referenca është edhe muzikore në krijimet. Është pothuajse e kotë t'i kujtojmë lexuesit se Pino Bova është një nga poetët më të mëdhenj që kemi sot dhe pikërisht sepse poezia e tij, pavarësisht se është e brumur me jetën reale, veprimet e përditshme dhe vlerat qytetare, di të fluturojë drejt sferave të një kompozimi dhe lirikë asnjëherë



e ekzagjeruar, për të kapur imazhe, mendime, metafora që ndjekin njëra-tjetrën, duke hapur kuptime që vetëm poetët janë në gjendje t'i kuptojnë në tërësinë dhe nuancat e tyre.

Dhe mrekullia është se kur njeriu, pavarësisht se ka pasur marrëdhënie të vazhdueshme me poetët dhe letrarët e mëdhenjë nga e gjithë bota, dhe pavarësisht se është i njohur, kurrë nuk nxjerr në pah aftësitë dhe substancën e tij të nivelit më të lartë. Është një virtut jo pa vlerë, që e lejon të jap dhe të marrë nga të gjithë pasurinë e entuziazmit, bukurinë e besimit në Fjalën.

Më duket e drejtë që duhet njohur edhe në Kosovë e Shqipëri, troje që kanë filluar të ndezin interesim të ri për poezinë, veçanërisht atë italiane. Ka shumë prova të thëna dhe ky përkthim i Anila Dahriut është sigurisht një zgjedhje që duhet mbrojtur. Një konfirmim.

Nuk dua të devijoj duke tjerr lavdërimet për mikun tim poet. Poezia e tij do t'ju japë më tepër se thëniet e mia të varfëra, sepse di të shkojë drejt e në zemër, di të përqafohet dhe bëhet, e them me fjalën që dua më shumë, "brumur" për të na rritur, për të na jep një pikë uji si të "ndërgjegjës" për të cilën foli BABA Dante.

Jam shumë i lumtur që ky bir fisnik i Kalabrisë mirëpritet në gjuhën shqipe sepse në Kosovë dhe Shqipëri do të gjejë përqaftime të vërteta për shkak të afiniteteve ekzistuese me Kalabrinë.



Premisa nga autori

Mendova se kalimi i ngadaltë i viteve mund të qetësojë atë forcë të brendshme që më shtyn të hyj gjithmonë në arenë për të folur për ndjenjat e mia, dëshirën time për të lundruar nëpër botë të pashkelura, të cilat për të tjerët janë skena boshe mosekzistenc ose vendesh. Megjithatë jam këtu për t'ju thënë se ka gjithmonë një mënyrë për të dëshmuar jetën, konsistencën materiale e cila nuk përbëhet vetëm nga gjestet e përditshme me gjuhën e përsëritur, rezistencën, por nga lëvizjet e shpirtit që ngrenë trupin për ta bërë atë të paprekshëm, por atletik, vizionar por realist, i zhytur në një lojë rigjenerimesh dhe rilindjesh që sjellin një emocion që nuk është ndjerë më parë.

Në gjithë këtë ka një sfidë ndaj vetes, një përpjekje e ndjerë që Josif Brodsky e quajti "kërkim për shenjtëri" që e shtyn një poet të pajiset "me gozhdë e çekiç / të ngjitet në majën e tij të pamundur" (Bova) dhe të përballet me të vështirëme ushtrimi e "arritjes së penës në pikën më të lartë të shpirtit".

Çfarë është jeta, në fund të fundit (Uliksi, Uliksi!), nëse po dëshira e vazhdueshme për të kërkuar shtigje dhe mundësi të reja, përgjigje të reja për pyetjet kapitale të mbetura pa përgjigje? A nuk ekziston gjithmonë brenda nesh dëshira për të kapërcyer çdo kufi për të kërkuar atë pjesë të vetes më të mirë të aftë për t'i dhënë kuptim jetës sonë të shkurtër në tokë?

Ky gjest është përsëritur që nga origjina e ekzistencës sonë.

Motori që na drejton nuk mund të ndalet në konsolidimin e pozicioneve tashmë të fituara, duhet të shkojë më tej, deri në zbërthimin e çdo rendi formal, deri në rigjenerimin e gjërave të marra padyshim, për të pushtuar atë të re, të gjallë, të papërsëritshme të fiksuar ku mbetet si humbja jonë dramatike.



Poezia nuk do të jetë kurrë një arratisje. Shqisat profetike justifikojnë arsyet e përplasjes me të tashmen e ekspozuar në mënyrë dramatike me pabarazitë, paragjykimet, egoizmin e saj, me dhunën, barbarinë, çnjerëzimin dhe e shtynjnë vështrimin drejt së ardhmes për të kërkuar harmoninë, për t'u ndjerë pjesë e së tërës.

Poezia është klithma e mundshme në mbështetje të të pafajshmit, të fundit, të sakrifikuarit. Frymon dhe ushqehet nga sytë mikpritës, krahët bujarë, intuitat parashikuese dhe të pashpjegueshme për origjinalitetin e tyre. Ajo lë gjurmë dhe simbole sepse dëshiron të bëhet zëri i njerëzimit dhe i kohës së saj.

Është një moment në të cilin kthimi në poezi bëhet vërtet një nevojë e pashmangshme, për t'i dhënë hapësirë dëshirës sonë për liri, për të shprehur një lëvizje çlirimtare, për të ofruar një mundësi të re në kohën e disfatës.

Shkruan Montale:

*Nuk jam Leopardi, lë pak për të djegur
Pothuajse është e tepërt të jetosh në përqindje
Jetova aq pak, mos më shtoni dozën
Shpesh halli bie mbi hallexhiun.*

Vargu shikon botën për të na dhënë një dorë bujare, për të na shoqëruar në heshtje, për të na shkundur nga tortura, për të hapur dyert për të pamundurën, për ëndrrën, për të vërtetën.

Dhe nuk kërkon asgjë në këmbim, sepse kështu i hap krahët poezia. Vetëm për dashuri.



Më adopto.

*Mos më bëj të qëndroj larg
me zhurma të ëmbla,
nga telefonatat që sapo kanë ardhur
në dhomat e zemrës.*

*Unë dua ta lehtësoj barrën time
ta zgjeroj kthesën e kohës
dhe të gjërave.*

Tashmë jam gjithçka dhe asgjë.

*Madje mund të të shoh
pa vello.*



“PETKU I SHEKUJVE”

1.

Përherë, anija ndalet në breg
mund të lundrosh në çdo vend
ta bësh këtë edhe për fat
nëse, në çdo frymë ka jetë,
madje, edhe brenda erës.

Zbulova ishujt e qiellit
shpesh koha nuk është bujare
por, kur e shikojnë njëri-tjetrin së largu
ende, mund të ëndërrosh,
madje, t'i dëgjosh dhe sirenat.

2.

Ndonjëherë gjethja përkulet
në degën që ndien dhimbje
është një mënyrë për ta dëgjuar
kohën e heshtur.

Ka zëra që nuk kanë jehonë
teksa gëlltiten brenda muzikës së erës
gjithsesi, nuk janë të humbur mes kohe
çdo shpirt ka të ngjashmin e vet
që tundin heshtjet,
madje, dhe sytë shkulmohen nga habia
si figura e Krishtit.



3.

Mbi gur nuk mund të varem
sesa në kryq
madje, në shkretëtirë udhëtoi,
dhe interstiksionet zbuloj
me të tjera lëngështime

jeta ime gufon nga zhurmat e shpirtit
dhe, befas bie në angështi.

4.

Hajde më tej
ti erdhe
ti erdhe
më thërret era
më përzemërsi
sapo kishte mbirë një lule
mes oshtimës së shkëmbit,
për çudi nuk e kisha vërejtur kurrë.

5.

Kështu dëshiroj
që at dhe bir,
i dashuri im,
të gjejmë mënyrën për të folur
përherë me njëri-tjetrin,
të kapërcejmë tundimet absurde
të shkëpusim të vërteta të ndryshme.



Unë, lisi i lashtë
ti, kërcell njomështak
aspak, për t'u ndarë
as për t'u larguar.

*Shkëputur nga vëllimi me poezi
“Kaq e butë aq arratisur”*



1-

Uragan uragan
përse shpirti është i trazuar
të foljeve dhe të plotësuesve
nëse emri nuk e thyen pikën.

Dy pikë

Rasti i sipërm është një sediment periferik
që del përpara në gjumin e prishur
ndoshta ka lëkurë të ndezur
një tipar i tepërt i fletës
por, ndërtimi i detyruar nuk ka kuptim
ne lundrojmë në detin e emergjencave
madje konturit e përfunduar
janë mashtrime:

Si ne që e jetojmë iluzionin.

2-

O engjëlli i arratisur
në këto shpella ku neveritë
shfaqen në sipërfaqe me dufe e mllafe
e të papritura histerie.

Është e mundur që kafka
si një gjellë të avullohet
si drapër qelbesh të rrjedh
derisa të shfryni kulmet e çmendurisë.



Tavolina e vendosur në mes
sakaq afrohem i vetëm
ndiej njomështinë e njohur
zemra qetësohet,
unë rilind filiz
për fëmijët e rinj të artit.

3-

Për nënën time

Të vështroj me butësinë e zemrës
dhe nuk i di më horizontet,
as në gjuhë
as në gur të gdhendur nga poeti.

Kështu të mendoj, teksa je ulur afër telefonit
i lidhë minutat me fije
madje, më pëshpërit që:
“Jam mirë,
mos u shqetëso për asgjë, biri im”.
Dhe, nata e thellë tashmë mbërrin
aq me nxitimin, teksa mbyl frymët.

Unë nuk jam jeta e adhuruar
i jap pak buzëqeshje vdekjes
madje ta dish, çfarë dhimbje më shtyn
të kthehem përsëri në shtratin e lumit.

Ti nuk e di që pjeshka nuk lulëzon më
sepse i lashë të ikin datat
sepse fitoi vdekja



që korri shpirtin.

Ti nuk e di
dhe nuk dua ta përsëris më,
madje e mira është kështu
sikur është dashuria.

4-

Mirë se erdhe dashuri
nga stirpet e largëta.
Mirë se erdhe vend që buzëqesh
bregdeti i rigjetur
frymë e agut të ri.

I lidhuri me zinxhirë tani ndihet i lirë
vrapon me elektrik dore të ndezur
ndër kolonat e forta shekullore.
ndizet
ndizet
derisa shkulmon dritë.

5-

Më pas
dikush do të vëzhgojë
pi vetëm ujë,
vetëm një përbërje organike
të zbrazëtirave të qëndrueshme
më pas
do ta shohin pafundësinë e detit,
turmat e pafundme të njerëzve
e formojnë një oqean,
mbase, do të kenë frikë nga mbytja.



6-

Unë i dëshiroj fjalët
që rrjedhin si lumenj
dhe janë curila burimi
të dobishme për njerëzinë.

Kam nevojë për qiellin
sepse në pasqyrat e shpirtit
nuk vështrova
te transparenca gjenden reflektimet
teksa luan çdo kufi.
Këtë mbrëmje më duhet të fluturoj lart
ta ndjejë dashurinë e botës.



VËRSHIMET

Në këtë kohë të natës,
nga të gjitha netët,
marr lapsin dhe letër
(si gozhda dhe çekiçi)
të gdhendi majën time
të pamundur.

Kaherë më rrëmben një erë e fortë
dhe nuk di të mbrohem.

Nëse plagët digjen
i mirëpres si stigmat
nuk ndiej asgjë që mbaron,
asgjë të pandjeshme.

Unë jam gjallë dhe frymoj
në trupin e një fjale
duke ecur.

(Nga libri: Pema e bukës – 1992).



SOT JAM NJË PIKË NË SHESHIN E MADH

Çfarë rëndësie ka nëse je gjallë apo i vdekur
nëse je në vetmi
po që se jemi vet vetmia.

Hëna kërcen jashtë
nga orbitat e zakonshme
të gjithë e shikojnë me sy
të shpirtit të saj
shumë herë të ngjashëm
nga një cep i shtëpisë.

Vetmia i mbyll burimet
edhe nëse i lutesh Zotit aq të largët
asnjë zë nuk përgjigjet.

Pa zjarr të shkrumbet
pa dashuri
madje asnjë faqe nuk frymon
dhe asgjë e rëndësishme nuk ka peshë
të mbetet art.

(Nga libri: Pema e bukës– 1992)..



NËSE TI MË VËSHTRON TANI ME TRANSPARENÇË

Mund të kujtosh vendet e njohura:
kthesat e rrugëve
kryqet e ndriçuara të kishave
fenerët e fokusuara mbi statujat e burrave gënjeshhtarë.

Zakonisht është një ardhje e ikje e njerëzve përherë të njëjtë
si në korrin e qiellit
dhe nëse diçka fiket ose diçka ndizet
tek shërbëtori budalla nuk e këqyr
i lodhur nga lojërat e zakonshme me hënën.

Qyteti është në sy Moneti im:
aktori nuk jam unë, që kafshoj kohën
por nata e ëmbël që bie në det
një magji lëvizjesh të papritura
ndërsa njeriu për çudi shikon
kullën e kullave ku do të lutet
çdo histori tjetër.

Do të ketë fund, do të ketë fund
por nuk do të fitojë ai
manekini i paaftë
që ndizet papritur për të bërtitur:
mjaft!

Turneu tashmë ka mbaruar
rrota që na shtyu aq lart
tashmë po ulet
së bashku edhe pak
një vështrim te palma që përplas bishtin
një buzëqeshje rrufe që çliroi shkopin
për ta thënë papritur një folje të re.



Nesër do të jem lëndinë
dhe ti nuk më shkatërrove
nesër do të bëhem erë
dhe ajo aromë që vjen, nga larg
aq e butë
aq mbështjellëse
për të cilën nuk dyshoja
madje, nuk e dija.

(Nga libri “Sa i butë, aq i arratisur” - 1999).



HERËN E FUNDIT DUKEJ SI PARAJSË

*Befas errësira mbërriti te ne
dhe papritur mungoj ajri.*

*Koha rebelohet kundër tradhtive tona,
uji vërshon buzëbrigjeve
dhe rimerr oqeanin nga erdhëm.*

*Era kërkon të çlirohet
nuk ndihej më
në këtë kohë të padrejtë.*

*Vetëm bretkosa e varur nga një skaj
e frikësuar, rifillon koncertin e saj
kështu do të rinisë një tjetër ag.*

Reggio Calabria 24.12.2020.



Nisë ushqyerja

*Nga një lindje
pastaj janë vërshimet
i fryjnë lumenjtë
sytë kthehen përmbys në vorbulla
gati për të shqyer trupat pafund.*

*Koha nuk ndalet,
nuk ndalet kurrë.*

*Fryn trupin me fjalë
ç'ekuilibron të gjitha hapat në rrugëtim,
pastaj shpërthen, na dërrmon,
dhe rrethin e hënës,
befas, nuk e sheh më.*

Reggio Calabria 24.12.2020.



UNË TË KAM DASHUR - THA BOTA -

të kam dashur, të kam dashur, të kam dashur.

Era hapi dyert
nuk kam fshehur asgjë për ty
mes kallamishteve të lumenjve të lashtë.

Ngriheshin ditët
e agimeve të paparashikueshme,
gurët çahen në zemër
dhurojnë perlat më të çmuara.

Të kam dashur vërtet
sikur të isha i përjetshëm,
sikur të ishte e mundur,
sikur ti të ishe Zot.

Por koha është e shkurtër,
e vështirë, e pamjaftueshme
nuk kupton, nuk sheh.
nuk mund t'i thyesh kufijtë tu.



VARGJET E REJA BIEN NJË NGA NJË

Dikush ndalon dhe më vështron,
i befasuar shoh të jetoj dhe të vdes
sikur shpirti - nganjëherë i trullosur -
i kthyer me vështrimin e tij të zbutur
me një shkrepje kërkonte ta mbronte.

Nuk është se koha më pret kaq gjatë
dhe bora nuk bie më nga pllajat
nuk është se dielli nuk picërron lëkurën
as nata nuk i errëson psetë e mia.

Vetëm se ndonjëherë distancohem
ta lejojë zemrën të dëgjojë,
për të kapur vezullimin në muzg
ku ylli nuk është gjithmonë flakërim,
as dita nuk është gjithmonë aq e kthjellët.

Dikush ka komplotuar shembjen
dhomat ua lanë vendin konflikteve
ato ishin gjithmonë rrobat e trupit tim
varur mbi degë, pa jetë.

Reggio Calabria 2 janar 2021.



Hapen kllapat e qiellit

*dhe stinët e reja shtyhen,
fjalët mezi mbaheshin
sikur ndërthurja të ishte aq e fortë
për të gjeneruar ndodhi të reja,
fuqi e rinisjes së shpejtë.*

*Kurrë vetëm nuk kam qenë në dhomë.
koha jashtë ikën
sikur udha të ishte aq e gjatë
sikur dashuria të ishte gjithmonë e përjetshme.*

*Drama nuk është të humbësh garën
pa e nisur makinën në kohë
drama është në mbërritjen në stacion
ku gjithçka mbyll aventurën
dhe zemra nuk përgjigjet kur rreh.*

*Kur zëra të fortë nuk dëgjon
dhe thonjëzat nuk hapen më.*

Sot moti po përulet

*pranë zjarrit.
djeg frymëmarrjet e fundit të oksigjenit.*

*Gjithçka do të shkojë në tym
edhe dega katrore
që nuk e kishte menduar kurrë
të bëhej shkrumb.*

*Pa ngjyra
nuk jetoi kohën e lulëzimit.*



Çdo gjë që nuk magjeps
meriton të braktiset
lulja që nuk lulëzon tashmë vyshket.

Reggio Calabria, 14 janar 2021.

Tani që jetoj si një ishull
dhe i kufizoj hapësirat dhe fjalët
duke kërkuar për të gjitha degëzimet
që më forcuan aortën.

Sa tufane mbërritën
nga pesë kontinentet
dhe sa gjethe të ngjeshura
para portës sime.

Unë mbeta kalorësi i lashtë
që kërcen i balancuar në një vijë
guaskë balte e përjetshme
ndërsa ka një mbështetje
të paqëndrueshme dhe të pasigurt.

Nëpër shumë porta të vrazhda kam kaluar
se nuk i përballoj dot kapitujt e çdo rënies time
ishte shpikja që më fitoi me kalimin e kohës
çasti i fundit që nuk e kërkoj më.

Reggio Calabria 22 janar 2021



Është dimër.

Bën ftohtë se kurrë,
jo për borën
që zbriti.

Nuk jam më e ulur në portë
askush nuk tejzgjatet
përballë dritares.

Zërat janë të panjohur
dhe ndihem aq larg
as nuk përpiqem t'i lidh
ato nyje, tashmë janë shkëputur.

Më britmën askush nuk e dëgjon
havlilla është zgjeruar.
madje ekziston rreziku i humbjes së rrugës.

Shkopi që bënte mrekulli
nuk mbahet më ndër duar,
nuk i përgjigjet më asnjë telefonate.



Është vështrimi i Leonardos,

Është vështrimi që shqyen pëlhurat,
që mpreh furçat me sy,
thyen harkun e kohës
dhe fluturon si shqiponjë
në zemër.

Është vezullimi që pi kufijtë,
i hap hapësirat,
fjalët e heshtura,
ujërat e shpirtit
e nis sfidën e tij në parajsë.

Uragani i natës endet
kthen orët me bluarjen e mullirit
gjumi pikturon
me dorën e tij të padukshme,
fryn shpimet e vjetra
dhe agimet rilindin së fundi
me qemerin e një qielli që shpërndahet.

Pafundësia e pyetjes shfaqet:
ku, ku fshihet Zoti?

Reggio Calabria 23 marzo 2021.



(Darka e Fundit e Leonardos).

Kur fole me dishepujt e tu

tavolina u shtrëngua në gjërat thelbësore
buka, vera,
vera, buka.

Vështrimi ishte tashmë i penduar,
gishtat preknin njëri-tjetrin të rraskapitur
dhe fjalët erdhën ngadalë,
tashmë të lënduar,
tashmë të shenjtë.

Një mantel i kuq po shkrihej
t'i mbledh përreth të gjithë
ishte koha për kohën e premtuar
të ofroj orën e vërtet të jetës.

Koha e pikturoi veten
në natën që ndau heshtjet
të rridhnin gjak.

Reggio Calabria, 23 mars 2021.



Giuseppe Bova

Ata gjithmonë duan të shkelin pëlhurën,
duke prerë sythat e pranverës,
të njollosin ujin e kulluar të përrenjve.
Ata nuk dorëzohen as nëse koha shkon
si minjtë brejtës.

Reggio Calabria, 23 mars 2021.



Gjithmonë kam ekzistuar

Si loti i parë i tokës
po provoja hapat e parë
të parin hendek hodha
zbrita dhe u përhap poshtë,
midis pemëve, luginave.
duke luajtur në saldimin e degëzimeve.
Fryhesha, mbushja gjoksin,
isha i tejmbushur.
isha i heshtur në liqenin e natës,
madje, thirrja të eturit në çdo agim.

Kam ekzistuar gjithmonë
kur përkula kokën brenda saj
kur u struka në zemrën e saj
shikoja kuptimin e gjërave
gjithçka ishte babai, nëna,
binar i jetës dhe i vdekjes
humbje dhe rilindje.
Rrëkëllim krijimi,
forca e lindjeve,
kohë e përjetshme.

Pema që spërkat është dëshmitare
po lëviz mbi çdo fund të pa eksploruar
shpërthej,
humbas dhe fitoj.
Frenat e kohës më përndjeki
të gjitha degëzimet e jetës time
çdo trup që ka ekzistuar ndonjëherë është një pyetje.

Reggio Calabria 04.06.2021.



Të shpirtit

Asnjë fjalë e përmendur
një ndjenjë tek shkon
lëreni kohën të na dëftojë
qoftë vezullim apo hije
qoftë vaj.

Mungesa luan në kozmos.
një erë e lehtë
e njeh misterin
që nuk shpjegon.
Yin dhe yang
tej kalojnë trupat
madje, nuk e njohin njëri-tjetrin.

Trumbeta krijon një tingull lavdie
por askush nuk e dëgjon.

Përkulem si askushi
që kalon heshtur
me boshllëqet e mia.

Reggio Calabria 13 prill 2021.



Kush flet për kuptimin e gjërave

Nuk shpjegon plotësisht
gjithçka dhe asgjë.

Rrotullohen duart e padukshme
dhëmbët e kohës
ata pastrojnë pluhurin e viteve,
rendin e njohur
të çdo ngjarjeje.

Mbuluar qielli me re
dhe shfaqet pafundësia
të një kalimthi të ngushtë
tek, për të folur për diçka tjetër,
nuk i frikësohet shpatës
që na shtyn brenda
si një hipokampus në rrjetë.

Në plazhin e shkretë hap çadrat
u rrëzova mirë këtë herë.

*Shënim: Hipokampus është një formim i vogël, i lakuar në
tru që luan një rol të rëndësishëm në sistemin lambik.*

Reggio Calabria, 13 prill 2021.



(Fjalë)

Koha nuk ka rëndësi.

Nëse do të flasësh
merr sërish detin
shko!

Emigrante siç je,
e plagosur, e përdhunuar,
e burgosur,
e çfarëdo mund të jetë
një rrymë e re,
stuhi.

Gjithmonë ka një vend
i panjohur
që shkëlqen natën
ndriçon.

Dhe fustani yt i ri
te unë bie në dashuri.

Reggio Calabria, 14 prill 2021.



Kur perëndon nata

Distancohem nga trupi im
të varur shpirtin në qiellin tim.

E dua jetën e re
që tashmë nuk më përket më
shikon garën
e një shqetësimi të largët
teksa përpiqet të kapë tjetër breg

dhe ku po shkon? - Unë pyes -
nuk e sheh që lumi është më i thellë?
Nuk e kupton që rrezikon të mbytesh?

Por dehja nuk e lëshon kurrë
kur zhytësi është në shtratin e detit
peizazhi zgjeron velluzimet,
reflekton, ndriçon, abstrakton
dhe qeliza ndahet,
vargu befas lind.

Në një çast ripërtërin universin.

Reggio Calabria, 14 prill 2021.



(Jugu)

Visheni këtë trup

E keni zhveshur prej vitesh
e keni lënë lakuriq.

Veç ju interesante
për t'u pasuruar
mbi shpatullat tona.

Keni marrë baballarët,
nënat, fëmijët
i keni përdredhur fort margaritat
në çezmat tuaja
madje as ujë
nuk sollët,
as pakot
me ilaçe.

Na keni mbajtur në grep
shekuj me radhë
urtë, urtë na ke.

Ju kemi dhuruar prej vitesh
një tokë e artë,
dielli, deti,
ngrohtësinë e ëmbël.

Na kthe shpirtin
na ktheni nderin dhe pasurinë tonë
vetëm ne mund t'ju shpëtojmë.

Reggio Calabria, 15 prill 2021.



Mos u pikëllo kurrë nëse flas për lirinë,
të ajrit që thith,
e duarve që fshihen
për fikun e detit dhe thikën
për të pushtuar përsëri
vezullime të reja në jetë.

Mos më pyet kurrkund nëse jam vetëm
të flas me retë
dhe nëse qielli më përgjigjet
dhe era rrëfen përralla
brenda shtratit të lumit të gërmuar.

Në shkretëtirën time të pakëndshme
një dashuri është si një kallam i rrahur,
në kuptimin e fundit,
në heshtjen e ndrydhur
janë shtylla kurrizore të pleqve
që e kanë varrosur fjalën
dhe presin rikthimin e aromës
të ulur si shekujt
derisa të bjerë këmbana e fundit
e kanë detin e ditëve
si një klithmë.

Lirinë e ndjej më shumë duke e dashur,
duke e thirrur në emër,
më shumë sesa duke e numëruar,
ndërsa një hap larg detit
asnjë anije nuk zbarkon
dhe nuk ka flamur që ngrihet
për oxhaqe të reja.

(Nga libri “Pema e bukës”- 1992).



Çajkovski djeg diafragmën e fundit.

Duart janë ngritur lart,
trupi krejtësisht i zhveshur
ku janë dallëndyshet?
Ku janë krahët të fluturojnë?
Populli im, njerëzia ime
vëllezërit e mi të vrarë.
Këtë mbrëmje vetmie
nata më bën shoqëri
do t'i bie pianos,
aq fortë, fortë, shumë fortë,
sepse dua të jetoj
si bari që rritet,
si ajri që thith
do t'ju lë të pastër.

Kangjellat janë të hapura,
nuk ka më nevojë për shtetrrethimi
për rojtarët
mund të vdesësh
një burrë nuk është burrë
por një vegël orë
kur të më takosh,
do të kem mundur një arratisje pa gjakderdhje.
Por ti je veshur si zhytësit,
modern në kurthe të pakthyeshëm,
nuk do të bëni dashuri si drerët
t'ju ndjekin mes luginave të gjelbërta
të përmbytjes dhe majave të pashkelura.
Duart janë të ngritura,
trupi krejtësisht i zhveshur
ku gjenden dallëndyshet?
Ku janë krahët të fluturojnë?

(Nga libri "Pema e bukës- 1992).



Ku e fshehe atë lulen Videla.

Si e bëre t'i mungonte fryma,
ta ndajë trurin
gjymtyrët e amputuara.
Ku e varrose trupin e tij Videla
dhe dashurinë për vendin e tij.

Kthehet fjala e fshirë,
flet goja e tij e mbyllur.
A nuk e dëgjoi ajri zërin e tij,
dhe ndoshta era nuk ka ushtuar
në male, në dete,
në rezervat, midis përrenjve.

Era na risolli zërin e tij Videla
atë buzëqeshje të ëmbël djaloshare
kur dita do të shkoj
kush do ta ketë varrosur ndonjëherë lirinë
madje dhe mendimin e tij për jetën.

Vdekja është kangjella hekurash
mbi sy
liria feks si një diell
mbi farën e shpërndarë.

(Nga libri “Pema e bukës” - 1992).



Çfarë po varrosim sot vëllezër?

Çfarë rrufeje e re na ka qëlluar
meqenëse të gjithë po ngashërohemi
dhe errësira u bë akoma më pus.
Louis do të luante për një kohë të gjatë
duke dëgjuar historinë tonë,
madje të tjerët do të kishin kënduar për ne.

Kanë vranë zërin tonë Louis
nga dymbëdhjetë vezullimet të ndarjes
na shkroi mesazhe për ne,
dhe na thirri të rezistojmë.
Poezia e tij ishte guximi ynë
na e vranë zërin
trupin ia dorëzuan nënës
varri ku flinte nuk ishte i murosur
ishte feks si vet besimi i tij.
Varri i tij nuk ishte errësire Louis
dhe ne jemi gjallë.

Ah, ku gjendet violina që askush nuk e dëgjon,
dhe nata që na izolon,
ajri që na ngushëllon jashtë shtëpisë,
nën çatinë e qiellit me yje
do të doja vërtet të ta shtrëngoja dorën,
dhe zgjidhja një mik, rastësisht,
kështu të flisja për lirinë time,
të jetës sime.

(Nga libri “Pema e bukës” - 1992).



Ishin si krahët e një harabeli

Krahët e tu të hapur anembanë
ata të ndoqën,
të rrahën,
kur të morën
qielli errësirë
dhe dimër acar
pemët u goditura për vdekje
sikur celulari të ishte xhelati.

*Mos harroni t'i rrëfeni djalit tim
të mos ketë frikë,
tashmë gruri është mbjellë
dhe se qielli është i pafundmë
aq sa pyka jonë e tokës
teksa përqafon gjithë botën,
edhe në Santiago gjithashtu
dhe kordilera që na izolon.*

Furia shpërndalet në të gjithë vendin
zogjtë janë larguar nga brigjet
dhe ngulen kudo.
Tashmë çdo njeri duhet ta dijë këtë
në këtë orë stolat janë zbrazur
në kopshtet e Santiagos
në këtë orë do të kishim bërë dashuri
madje ëndrra u shkëput nga gjoksi.
E gjithë bota do ta dijë
edhe pse patrullat na sulmojnë,
zemrat tona ndalen
te refleksi i fenerëve të rrugës.

U ngritëm dhe vrapuam
si përherë



sìç është koha
kur fryma bëhet kallkan
nga breshëria e pushkëve
lufta për fat nuk shkoi dëm.

(Nga libri “Pema e bukës - 1992).



Velloja we sapo ka rënë

Madje engjëjt, ata që na bërtisnin
me fytyrat e ngrysurat të fëmijëve,
ata që na këlthitën me emër në rrugë,
ata që detyrohen të arratisen
ose të rezistonin në prag të jetës,
engjëjt u harruan,
u nënvlerësuan
U VRANË.

Velloja sapo ka rënë
ndoshta ia vlen të bësh dashuri
e dashura ime le ta duam njëri-tjetrin çmendurisht,
ta duam njëri-tjetrin si dy të sëmur,
të tërbuar
le të vdesim
të vdesim, të vdesim.
Ah, sikur të çmendeshim nga dashuria,
nëse mundemi të copëtojmë jetën tonë
dhjetë, njëqind mijë herë
për të parë engjëjt,
engjëjt që janë pranë nesh,
engjëjt që na duan,
engjëjt që kanë humbur, engjëjt që na thërrasin.

Engjëjt që i kemi harruar.
Engjëjt që kemi VRARË.

(Nga libri Pema e bukës - 1992).



Çfarë dini për luftën,

të netëve të kaluara në llogore
me kallkan për të ftohur pushkët
përkrah të vdekurve pa emër.
Ne që e kemi ngarkuar pritjen
duke kafshuar thesin e hendeqeve,
ne që kemi pasur mall për arratisje
me fundin e breshërisë së milatriçeve,
ne mund t'u dëftojmë sa vlerë
ka kjo ditë me diell
dhe hapi i shpejtë me xhinse.

Asgjë e paktë nuk ishte lamtumirë
në shumë net të gjata agonie
kur te shokët
zëri dridhej
dhe rrufeja e Engjëllit
i çonte larg.
Sa herë me heshtjen e topave
kënga e gjinkallave na befasonte
sa herë me shëtitjet e hënës
u numëruan flakërimat e yjeve.

Jo, nuk mund ta fshish dhimbjen,
as orët,
as çastet e humbura pa dashuri.
Dhe të gjithë ata burra që ikën,
ata miliona frymorë
që nuk pipëtojnë më.

(Nga libri “Matja e njeriut “– 1984).



Keni dëgjuar për një refugjat

brenda një kurthi
pa spiun apo mashtrim
duke folur, për shokët e vjetër dhe idetë e reja
për të qenë i arsyeshëm
për degën e thyer të ullirit
dhe kristalit të krisur.

ke dëgjuar për babain e vrarë
të vëllezërve të humbur
të jetës së tij të koklavitur
në rrjetën e merimangës së pangopur
që zgjeron zotërimet e tokës
dhe pushton popuj.

Nëse keni dëgjuar për të
mos ja mbyll portën
mos e kafsho frerin, frerin e kalit
mbyllur në kafaz.

Pa kollare dhe pa prejardhje
liria ka mbërritur
është me ne
brenda shportës së udhëtimit
në shaminë e verdhë, jeshile, blu,
si të dëshirosh:
pa duar të lidhura
siç ke menduar gjithmonë:
pa gjakderdhur,
ti prej këtu, unë nga atje,
QIELL.

(Nga libri “Matja e njeriut” – 1984).



Flisni me mua.

Këto rrugë nuk mund të mbarojnë,
kjo dashuri nuk mund të ripërtërihet më
gjetkë
deti kthehet gjithmonë në brigje.

Ne ende nisemi nga e njëjta tokë
madje, kthehemi përherë në të njëjtën shtëpi
dhe endemi në të njëjtën vorbull
duke vijëzuar të njëjtën hapësirë kthimi.

Duke ngritur vështrimin lart qiellit
hëna na rrëmben
madje kurrë nuk e kemi menduar
ta braktisim.
Të thuash jo është thjesht herezi
për ne që kemi sytë
të shohim.

Reggio Calabria, 18 prill 2021.



Aty ku mbështjellin kohën

këto forma ajri
këto netë
dhe ditët
teksa përcjellin aurorat
drejt lumenjve.

Çfarë do të jetë e nesërmja
kjo kokrrizë e imja për ty
kjo faqe e shfletuar
dhe e gjetur.

Përkulet forca e asaj që jemi
kjo fjalë e sapo shqiptuar
sikur ti përkiste
vetëm erës.

Ndoshta një përbërje e tokës së përçarë
për t'i dhënë kohë farës
të lulëzojë.

Reggio Calabria 22.12.2021.



Vraponi

Po digjet kamxhiku i botës
mbi kurm.

Çuditërisht lypësi buzëqesh
kthen sytë dhe na vëzhgon
si një glob
ku do të mund të bjerë vallë hëna e saj?

Oh të shkruash për malin më të lartë
ose për detin e paanë
ishin qiej mbi qiell në qiell.

(Nga libri Sa i butë, aq i arratisur - 1999).



(Nga libri Oksigjeni – 2023)

Çdo vit pritja për njoftimin:

Atwood, Louise Gluck, Gurnah?
Dielli nuk do të shkojë të dremisi
një ditë më parë
dikush do të pyesë: kush jam unë?
Përse tani? Çfarë do të ndodhë?

Ka toka që dridhen
duken si duna barishte të gjalla
duan të thonë se edhe në shkretëtirë
jeta shpërthen përsëri nga vullkanet.

Ka erë, ujë, një det i paanë
të shtrembëruara zorrët qorrave të lindur
kërcejnë natën e rezistencës
hijet e shndritshme të çmendurisë.

Në mesnatë vezullojnë
vetëm për fluturat,
vetëm për ata që mund të shihen në çdo ag.

Reggio Calabria 07.10.2021.



Nëse mund të flisja me ty Lorenzo
përtej dhomave të tua shpirtërore
ku përbëhen valët
dhe erërat e lehta ngrihen lart
unë do të thoja që nuk është ankth i kotë
na rrëmbeve me vargjet e tua,
dhe bardhësia e vargjeve të tua
nuk kanë qenë varka lundërtare.

U ngritën shumë zëra
filluan të zbresin nga lumenjtë:
Gilda, Emilio, Rodolfo, Francesco,
një ushtri e vërtetë poetësh të zhdukur
me monumente të ngritura e të padukshme
në breg të detit tonë.

Asgjë nuk e ndreq kohën Lorenzo
as jeta
thesi hapet me një britmë
me pritshmëri pa vlerë për dashurinë
nuk bën të frymojë në kohë.
Tek gjethja bie
i skuq livadhet
e lë një farë të re të konsumuar
dhe nuk e dini për kë,
das nuk do ta dini përse.

Reggio Calabria 01.10.2022.

Poetët e zhdukur:

*Lorenzo Calogero, Gilda Trisolini, Emilio Argiroffi,
Rodolfo Chirico, Francesco Fiumara, Antonietta Maria
Corsaro*



Të gjithë kishim pardesytë tona të kuqe,

Caffè Pedrocchi, orët e paradarkës,
ku të takosh shpirtrat e humbur
që na dhuruan jetë tjetër.

Tashmë kemi jetuar, përjetuar,
me lëkurë të pagdhendur për t'u ashpërsuar
me fjalët që ishin në fund
dhe vononin të mbërrinin.

Por të flasësh me ta, për ta,
Ritsos, Walcott, Neruda.
Të flasësh me Brodsky, Kuazimodo, Montale,
nuk mund ta linte zemrën e tij të shuar.

Kështu Jabezi mori udhën e tij
portat e Mesdheut janë hapur
Adonis, Lorca, Bonnefoy,
dhe flukset e ylbereve mbërritën
me vezullimin dhe parfumin e agut të ri.

Nuk do të flas për kohën që më ka mbetur
do të eci përpara, e di, me sy mbyllur
sepse intuita ime ndjen një prani
pa një vegim tek ndizet
asgjë nuk merr, asgjë nuk ka rëndësi.

Reggio Calabria 01.10.2022.



(Në Krajovë)

I

Nëse mund të të flisja
tani në këtë kohë të natës
që na ndan,
do të thosha
që sytë e gruas së lashtë
që çelin në mëngjes
dhe të atdheut të lavdishëm
që kanë shpërndarë prej ditësh
erën e çmuar tek shpon
drejt në zemër.

Kështu po vij tek ty, i heshtur
të meditosh veten dhe të arsyetosh
për pallatet e përjetshme
të aventurave të reja
dhe portat e shqyera
nga stuhitë e shumta.

të dua si bir
dhe plisin që shpërndahet
me parfumet e tua.
Unë jam një folje e qiellit
dhe re që mbështjell
vendet e artit.

Do të kthehem t'ju tregoj për këtë
një dielli që është tashmë lartë
tani që po vijnë zëra miqësorë
nga kudo,
dhe ka pritje të vargjeve të tjera,
dhe një dashurie tjetër.



II

Herën e fundit

që u takuam
natë e thellë tashmë ishte.

po kthehej nga Caracal
dhurata e lashtë e historisë,
atë lidhjen që koha
nuk mund ta fshijë.

E bekuar qoftë fjala jote
dhe atë të njerëzisë
të ardhur, nga larg
të të jap bukë e verë
të çdo vendi.

Fara e tokës
nuk humbet.
Këtu, në pikën e kryqëzimit
e të fatit,
njeriu ndalon
të dhurojë frymë
atdhe për të gjithë popujt,
paqe për gjithë kohën
që do të vijë.

Reggio Calabria, 16 prill 2023.



(Në Iasi, Rumani)

Kur bie nata

dhe ti do të më thërrasësh
nuk do të jem kurrë kaq larg, Iasi
sytë do të rrëmojnë rrugët e tua
me erën delirante të vargjeve të mia
gjithçka do të ndodhë papritur:
do të hapen portat e shtëpive,
do të depërtojnë kishat e çmuara,
Teatri i operës, muzetë e tua.

Ende mbërrijnë fjalët e poetëve,
tulipanët që lulëzojnë nga livadhet e tua,
dhe asgjë nuk shkon kot, asgjë nuk vdes.

Hëna pozon me bardhësi të ëmbël
si përkëdhelja e një gruaje
këtu do të lind lumi im,
këtu do të shuhet malli im për ty
jeta kapet në një udhëtim
si një Odise e humbur për dashuri.

Reggio Calabria 06.07.2023.



(Për nënën time)

Më kishe thënë -

koha shkon.
dhe ajri është
më i dendur
ngadalësonte përplasjen
kthehesh për ti parë shtigjet
agimet e gëzimit që ke përjetuar
dhe duket sikur mund ta shohim ende të varur
jetën,
si një çarçaf i bardhë
për ta shpëtuar.

Te pema që mban çdo copëtim
edhe sa kohë - pyesni -
edhe sa orë
por të dëgjosh një psherëtimë të lehtë
një fjalë
të kërkosh një dritëz të zbehtë
ose të zgjatësh dorën
ta mbaje një ëndërr
çfarë kuptimi ka.
Errësirat janë qëllime për t'i shkëputur
madje heshtja të këshillon
poezia e ngadaltë gremiset
të zbulohet një sekret.

Në kohën që shkrep feksin e ri
dhe e bekon vallen tënde me shpirt
mos pyet më,
mos thuaj më.

(Nga libri Oksigjeni – 2021).



Derisa të dëshirosh të flasësh me mua

Unë do të qëndroj me ty gjithë natën
sepse gurët kanë krijuar kaherë
një qiell me yje
shpirti është diçka tjetër brenda meje
i shqetësuar
kërkon qelibarin ngado.

Por si të ndiqni orbitën
tek i shpëton alfabetit
fjala që lind papritur
si një rrufe drite në mes të qiellit.

I pakapshëm provoj vijën e errësirës
Mos më thuaj që është e pamundur të vdesësh
në gjuhën e zakonshme.
Vë veshin të dëgjoj
dhe për dridhmën e faqes së dëlirë -
nëse mundesh -
përkthe erën
përkthe kuptimin e një çasti tek arratiset.
Dhe nëse mendon që mund të dëgjosh
mos dyshon:
akoma është Zoti që këndon
me zërin e bilbilit.

(Nga libri Sa i butë, aq i arratisur - 1999).



Fjalët bien një nga një

si guralecët në kalldrëm
ndonjëherë të humbura
dhe si të tjera komponime grumbull
shtohen,
si mendimi që merr formë.

Llamba nuk u ndez pa shkak.
Deti u rrit brenda shtëpisë
për dorën që mbështetet te veshi
sakaq përgatiste varkën e lamtumirës.

Më kujtohet ngjarja e shënuar
oxhaqet ende plot tym pakufi
më kujtohet që shfaqeshe nga larg
në konin e feksit të mbrëmjes
si protagonist i udhëtimit tim.

Sapo kisha vdekur
ndërsa t'i fekse në jetën time.

(Nga libri pallto Millennium – 2003).



Faqja e fundit.

Do të jetë koha
që arratiset
me mbylljen e viteve
si gjethet
bien në buzë trotuaresh
për të pushuar.

Pas pak
fjalët e zverdhura
do të kenë shije të lashtë.
do të jetë zëri i ngjirur t'i shpjegojë
imazhet që shihen në fund
e pastaj i lëmë të shkojnë.

I gjalli shatërvan
do të na mbulojë në përjetësi
madje era do të zbulojë
Dhe niset, rrëshqet
valixhja e hapur
mbi det.

Çdo vend i përket
pafundësisë.

(Nga libri Sa i butë, aq i arratisur - 1999).



Kur nuk do të ngjit më shkallët

ku mullaga lulëzon në ballkone

Do të jem bërë një gur që shkëmben fjalë me natën
dhe troket lajmësi në portën e kohës.

Larg nga portat e tërmetit

do të kem shkruar poezi dashurie
era do t'i përndjek në çdo breg.

Tufa gruri do të rritet nëpër moçal

ku deti zërin kish humbur.

Kështu do të ndodh nëse zëmra ime nuk vdes

ka një arsye të vyer këtë botë.



Shkruaj, shkruaj poet

Tymi i madh i sotshëm
përmbledh historinë e piramidat
nuk e di nëse dielli shkëlqen
apo bie shi kur të dëgjoj
e gjen vetveten, por asnjë frymor
duket që kur hapen kangjellat
dhe karrot humbasin në kërkim të një shtegu.

Pa sinjale
është labirinti i qiellit
ku mizat shkelin
pa kokë është krijesa
ndërkaq i jepet dëfrimit.

Shkruaj, shkruaj, poet
për aq sa nuk ke parë,
për atë që formë dhe fjalë nuk ka
dhe ngjason me erërat.

Ankthi pushton, ndaj
nuk ndihet që çdo lindje është dhimbje
tekta zbraz nga çdo mungesë
çmimin për vezullim,
ndoshta, gjendet te jeta.

(Nga libri “Pema e bukës – 1999).



Pasthënie

Nga Anila Dahriu

Ishte e bukur dhe emocionuese të përktheje poezitë e Xhuzepe Bovës. E bukur sepse i dëgjova fjalët e tij e plot jetë, entuziazëm, emocione. Emocionuese sepse më erdhi pothuajse natyrshëm të përkthej vargjet e tij që kanë thjeshtësinë e të mëdhenjve. Portreti i Bovës nga Dante Mafia është shkruar me shpirt dhe jep një ide të saktë të poetit dhe vargjeve të tij. Do të shtoja se leximi i këtij libri do t'ju çojë në një dimension të ri në të cilin mund të dëgjoni jehona të lashta, por të lidhura me të sotmen. Është e vërtetë që poezia e vërtetë është e përjetshme, por nëse, si në këtë rast, koha e lashtë zgjerohet dhe bëhet e gjitha kohët, atëherë duket qartë se ne e gjejmë veten në praninë e një autori që ishte në gjendje të kuptonte rrjedhshmërinë e udhëtimit, që e përmend Mafia, për të na marrë me vete në kërkim të atij vendi që është bërë nga ëndrrat, vendit të përjetshëm.

Bukuria e kësaj poezie qëndron në qetësinë e saj stilistike, në ashpërsinë e saj, le të themi, muzikore. Giuseppe Bova ndez vargjet e një muzike shumë personale që bëhet një dritare e hapur në detin e Reggio Calabria. Sepse Kalabria ekziston dhe është e gjallë, por në një moment bëhet Calabriamondo, sepse idetë e shprehura nuk lidhen me vendin e origjinës, por janë momente që i përkasin të gjithëve.

Por pikërisht ngaqë është poezi e vërtetë, pa konotacione të tepërta, nuk ishte shumë e lehtë ta përkthej. Frika e shtrembërimit të një kuptimi, e shtimit apo e heqjes së diçkaje të huaj në diktatin e Bovës më mbajti vigjilent, edhe nëse është normale të pajtohemi me thënien “përkthyes tradhtar”, besoj se i kam qëndruar besnik botës së poetit. Kam përkthyer me mendje, por edhe me zemër.



Biografia

Giuseppe Gova, i lindur në Reggio Calabria më 08 janar 1946. Diplomoi në Ekonomi dhe Tregti, ndërsa bëri master për Operatorët e Zhvillimit c/o Instituti i Lartë Evropian i Studimeve Politike;

Këshilltar për kulturë, për p.i. për shërbimet demografike dhe planifikimin urban të Bashkisë së Reggio Calabria (1980 - 1989); Drejtues i shtetit që nga viti 1990; Koordinator Rajonal i Sektorit të Motorizimit Civil të Kalabrisë; Ish-drejtor i përgjithshëm i spitalit Pulian Ciaccio CZ.

Çmimi i Kulturës nga Kryesia e Këshillit të Ministrave 1974; Superintendent i Teatrit Bashkiak “Francesco Cilea” të Reggio Calabria.

Ish-kryetar dhe përfaqësues ligjor i Universitetit për të Huajt “Dante Alighieri” të Reggio Calabria.

Anëtar i Këshillit Kombëtar të Shoqatës Dante Alighieri; President pro-tempore i rrethit kulturor Rhegium Julii.

Anëtar nderi i Akademisë Ndërkombëtare “Mihai Eminescu” të Krajovës.

Medalja “Mihai Eminescu” për veprimtarinë poetike kombëtare dhe botërore. Autori i 10 vëllimeve: “Le të shtrëngojmë duart” (1968); “Burrat gjithmonë” (1977 – ed. Parallelo 38); “Dimension man” (1984 – Ed. Parallelo 38); “Pema e Bukës” (1991 – Ed. Laruffa); “Kaq i butë, aq i arratisur” (2003 – Ed. Rhegium Julii); “Pallto Millennium” (2003 - Ed Rhegium Julii); “Fjala e përjashtuar” (2003 – Ed. Iiriti); “Oksigjen” (2021 – gjerdan Rubbettino Iris); “Dëshmi” (2021 - Ed. Rhegium Julii); “Politika dhe shoqëria” (2021 - Botimet Rhegium Julii).

Dy ese: Perpendicularly bosh (1982) një ese kritike për poetin Lorenzo Calogero (ed. Parallelo 38); Plani strategjik për zhvillimin e qytetit metropolitane të Reggio Calabria



(2005 – Botime të Klubit Rotary C); Përkthime të veprave në anglishte, spanjisht, rumanisht.
Botimet e tij janë vlerësuar nga Çmimi Nobel për Letërsinë Seamus Heaney, nga Walter Mauro, Corrado Calabrò, Dante Maffia, Nelo Risi, Claudio Marabini, Antonio Piromalli, Giuseppe Amoroso, Gilda Trisolini, Roberto Pazzi, Giuseppe Selvaggi, Dante Troisiti, Luca Desiato dhe të tjerë. Ka fituar çmime të shumta letrare në të gjithë Italinë dhe ka shkruar disa parathënie/recensione.



Përmbajtja

PARATHËNIE	6
Premisa nga autori	8
Më adopto.	10
Për nënën time	15
VËRSHIMET	18
SOT JAM NJË PIKË NË SHESHIN E MADH.....	19
NËSE TI MË VËSHTRON TANI ME TRANSPARENÇË.....	20
HERËN E FUNDIT DUKEJ SI PARAJSË	22
Nisë ushqyerja.....	23
UNË TË KAM DASHUR - THA BOTA.....	24
VARGJET E REJA BIEN NJË NGA NJË	25
Hapen kllapat e qiellit	26
Kur perëndon nata.....	35
Çajkovski djeg diafragmën e fundit	39
Ku e fshehe atë lulen Videla	40
Çfarë po varrosim sot vëllezër.....	41
Ishin si krahët e një harabeli	42
Velloja sapo ka rënë	43
Çfarë dini për luftën.....	45
Keni dëgjuar për një refugjat.....	46
Flisni me mua.....	47



Aty ku mbështjellin kohën	47
Vraponi.....	48
Nëse mund të flisja me ty Lorenzo	50
Të gjithë kishim pardesytë tona të kuqe.....	52
Derisa të dëshirosh të flasësh me mua	57
Fjalët bien një nga një.....	58
Faqja e fundit	59
Kur nuk do të ngjit më shkallët.....	60
Shkruaj, shkruaj poet	61
Pasthënie.....	62



Giuseppe Bova

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

821.131.1-1

Bova, Giuseppe

Vërshimet : poezi / Giuseppe Bova ; përktheu nga
italishtja Anila Dahriu. - Prishtinë : IWA Bogdani,
2025. - 66 f. ; 20 cm. - (Biblioteka”Adem Shkreli”)

1. Dahriu, Anila

ISBN 978-9951-394-37-6

